



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.442/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuara ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.442/2025 datë 07.02.2025, të ushtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.442/2025, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, ankuesi pretendon se me datë 06.02.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka organizuar një tubim elektorale në qytetin e Pejës, në të cilin tubim janë evidentuar raste të pjesëmarrjes së fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç. Parashtruesi i ankesave thekson se me këto veprime kandidati dhe subjekti politik LVV kanë bërë shkelje të nenit 5, paragrafit 3 të Rregullores për Fushatën Zgjedhore nr. 07/2024. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi.

Më datë 08.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për ankesën e parashtruar kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 08.02.2025 në ora 18:30. Në përgjigje në ankesë të parashtruar me datë 08.02.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e ka kundërshtuar ankesën si të

pabazuar me pretendimin se fakti publikimi i disa fotove në tubimet elektorale, në të cilat vërehen fëmijët nuk qëndron aspak dhe është jashtë standardeve të kërkuara edhe me nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024.

Parashtruesi i përgjigjes ne ankesës ka theksuar se siç vërehet edhe nga provat e bashkangjitura të pretenduesit, LVV, nuk është e ndërlidhur me angazhimin e fëmijëve në fushata, gjithashtu për më shumë fëmijët shihen në prezencën e prindërve dhe janë në përputhje të plotë me rregullat zgjedhore, përkatësisht me nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi. Dhe se nuk përben shkelje te dispozitave përkatëse ligjore te cilave ju ka referuar pretenduesi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj, dhe vlerësoi ankesat gjeti se :

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se subjekti politik në fjalë nuk ka bërë shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, i cili përcakton se*Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.* Mbi bazën e provave më saktësisht fotografitë e paraqitura nuk mund të vërtetohet se fëmijët kanë qenë pa përcjelljen e prindërve. Në fotografitë e ofruara si provë me fëmijë shihen edhe persona madhor qe mund të konsiderohen se kanë qenë prindërit e tyre. Ne anën tjetër neni 117 par. 3 LZP, kur vendos për ankesat PZAP bazohet në prova të qarta dhe bindëse. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në ankesë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 te LZP-së, nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.442/2025 datë 10.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.